



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1313/18

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI16/18

Parashtrues

Sahit Musa
si përfaqësues i pretenduar i K. N.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1.
nr. 313/16, të 10 majit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sahit Musa, avokat nga Vitia, i cili pretendohet të jetë përfaqësues i K. N. (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

Vendimi i kontestuar

2. Përfaqësuesi i pretenduar konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 313/16, të 10 majit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, me të cilin përfaqësuesi i pretenduar pretendon se K. N. i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 6 shkurt 2018, përfaqësuesi i pretenduar e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 8 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 12 shkurt 2018, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e pretenduar për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësim të kërkesës me informata shtesë. Një kopje e kërkesës, në pajtim me nenin 22. 4 iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtar raportues, gjyqtarin Safet Hoxha.

12. Më 16 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
13. Më 22 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

14. Gjykata nuk i referohet fakteve të këtij rasti, pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizim për të parashtruar këtë kërkesë në emër të K. N.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Gjykata gjithashtu nuk i referohet as pretendimeve që pretendohet të jenë të K. N., pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar pa një autorizim të vlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafit 1 dhe 7 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

18. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili përcakton:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.

19. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], paragrafit (2, c) dhe (3) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

[...]

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor;

[...].

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm”.

20. Gjykata rikujton që kërkesa është dorëzuar nga një avokat i cili pretendon të jetë i autorizuar për të përfaqësuar K. N.
21. Gjykata, gjithashtu, rikujton se kishte kërkuar nga përfaqësuesi i pretenduar ta plotësojë formularin e kërkesës dhe ta dorëzojë autorizimin përkatës të vlefshëm.
22. Megjithatë, përfaqësuesi i pretenduar nuk ka dorëzuar informatat dhe dokumentet e kërkuara.
23. Në lidhje me këtë, Gjykata më tej i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

[...]

“(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.”

[...]

24. Gjykata konsideron se përfaqësuesi i pretenduar nuk ka ofruar informata dhe nuk ka dorëzuar dokumentet siç i ishte kërkuar nga Gjykata. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë.
25. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, më 22 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi